



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, Thirrjes publike për aplikim të shpallur nga Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural 12-320-43053 e datës 08.09.2020, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E
KËRKESAVE TË FERMERËVE PËR KOMPENSIMIN E DËMEVE

Neni 1

Formimi i Komisionit dhe përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të fermerëve konform Thirrjes publike për aplikim të shpallur nga Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural 12-320-43053 e datës 08.09.2020, për kompensim të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore (breshëri, era dhe shiu) dhe dëmet e shkaktuar nga mungesa e shitjes së perimeve për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid -19, (në vazhdim të tekstit Komisioni), në këtë përbërje:

- ① Afrim Sadiku, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari , Kryesues
2. Pajtim Krasniqi, Drejtorati për Inspektorat, anëtar
3. Sadete Maholli, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari , anëtare

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë e Komisionit

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë si vijon:

- Bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për kompensim të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore (breshëri, era dhe shiu) dhe dëmet e shkaktuar nga mungesa e shitjes së perimeve për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid -19,
- I rekomandon Kryetarit të Komunës listën e fermerëve përfitues duke hartuar procesverbal për secilin aplikant duke përcaktuar edhe vlerën e demit të shkaktuar ose humbur.

- Rekomandimet e Komisionit merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.
- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesave publikon listën preliminare të përfituesve ku palët e pakënaqura kanë drejtë ankese në Komisionin e ankesave brenda afatit 5 ditor nga dita e publikimit të listës.
- Pas përfundimit të procedurave të ankesave, Komisioni vlerësues shpallë listën finale nëse ka ndryshime nga ajo preliminare varësisht nga Vendimi i Komisionit të ankesave.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

1Nr. 320 - 48350
Lipjan, 05.10.2020

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

